



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POLIÇAN
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. ___Prot

Polican , me __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Mbrotjtje lumore gjatesore nga lumi Osum , fshati Mbrakull, Poliçan”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45210000-2 **Punime ndertimore**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij dhe jane verifikuara nga specialistet e fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike, argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, inxhinier i DPZHT Bashkia Poliçan anëtar i njësisë së prokurimi, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.Kriteret e vecanta ekonomike jane hartuar nga ekonomisti specialist i fushes antare i njesise se prokuimit dhe kriteret ligjore nga juristi specialist i fushes antare i njesise se prokurimit

VLERA E FONDIT LIMIT: 57 567 958 (pesedhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mij e nentëqind e pesëdhjetë e tete)lek pa tvsh Monedha, lek Burimi i financimit: Nga buxheti i shtetit 2023 .

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'' i ndryshuar , nga subjekti projektues dhe eshte verifikuara nga specialistet e fushës , inxhinier prane Drejtorise se Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Polican ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve te bera ne Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020 ,2021, dhe 2022** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates pasi proceduar eshte ndermjete kufirit te larte dhe te ulet monetar. .

Argumentimi: Këto kriterë janë vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në neni 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe nenit 43, pika 5, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Bazuar në rekomandimin e app nr. 7998 prot date 24.12.2021 e cituar :

Nisur nga problematikat që konstatohen në hartimin e këtij kriteri, si dhe bazuar në parashikimet e nenit të sipërcituar, rekomandojmë që hartimi i kriterit të xhiros mesatare vjetore, të jetë si më poshtë:

"Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare..... (shënim: në çdo rast autoritetet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë vitet konkrete, të cilat duhet të jenë deri në 3 vitet e fundit financiare), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se:

-dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës (në rast se procedura është mbi kufirin e lartë monetar).

-vlera e parashikuar e kontratës (në rast se procedura është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar).

-40 % të vlerës së parashikuar të kontratës (në rast se procedura është nën kufirin e ulët monetar, ose "Shërbim konsulence").

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021 dhe 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit

deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Bazuar ne rekomandimin e app nr. 7998 prot date 24.12.2021 e cituar :

Gjithashtu, autoritetet/entet kontraktore mund të kërkojnë edhe bilancet vjetore të operatorëve ekonomikë, për një periudhë deri 3 vitet e fundit financiare. Në rast se kërkohen bilancet e 3 viteve të fundit financiare, rekomandojmë që autoritetet/entet kontraktore të përfshijnë në kriter përcaktimin që kriteri quhet i përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rast se kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Së fundmi, në lidhje me këtë kriter, për sa i përket viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros mesatare vjetore dhe bilanceve, rekomandojmë që AK të përcaktojnë specifikisht vitet konkrete të kërkuara për paraqitjen e këtyre dokumenteve (deri në 3 vitet e fundit financiare), duke mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e legjislacionit të fushës, aktualisht, nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës”.*

2.2.3 Një dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 , dhe kestet te maturuara te vitit 2023 , referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin per te gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas ekstratit te QKR. (në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes se Formularit përmbledhës te Vetë deklarimit sipas shtojcës 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3.Kapaciteti teknik:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet , konkretisht në vlerën 28 783 979 (njetzet e tete million e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mij e nentëqind e shtatëdhjetë e nente) lek pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht 115 135 916 lek(njetëqind e pesëmbëdhjetë million e njëqind e tridhjetë e pesë mij e nentëqind e gjashtëmbëdhjetë lek) pa tvsh..

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkojmë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore,
- Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
- Çertifikatën e marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkojmë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore,

- Akt kolaudim i objekti; (***në rastet kur ky dokumentacion lëshohet***)

Shënim: Vertetimi duhet të percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Pika 2.3.1 germa a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë **të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të permbushë këtë kusht.**

Kurse pika 2.3.1 germa /b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit **në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.** (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën jo më të vogël se 50 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

- Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

-
- Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatorët ekonomike duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne

veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë
- NP-4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha , tramvaj, metro, pista aeroportuale
- NP-9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime
- NP-12 B Punime te inxhinieriese se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS- 18 B Punime topografike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas projektit dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Detajimi i kerkeses se cdo license sipas punimeve qe do te kryhen:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas projekt idese.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas projektit dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e

dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Detajini i kërkeses se cdo license sipa punimeve qe do te kryhen:

1. NP-1 A Punime germimi ne toke

1	3.2	Prerje bime te vogla F - 10 cm	m2	405
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh 10-20 cm	cope	58
3	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	2900
4	3-47/1b	Mbushje e ngjeshje me dhe	m3	1620

2. NP- 4 A Rruge, autostrada, mbikalime, etj

7	AN	Shtrese rere bituminoze t=8-10cm rruga	m2	3072
---	----	--	----	------

3. NP-9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime

5	3.193/b	Shtrese zhavor lumi t=20cm, rruga	m2	3300
6	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm rruga	m2	3300
8	3.235+an	Struktura monolite betoni C 16/20 me 20% gur	m3	2415
9	An-50	Transport element betoni dhe b/a me auto deri 10 km	ton	5072
10	3.352	Mbushje me gur kave per skoliere	m3	2838
11	AN 51	Transport materiale ndertimi, gur kave me auto deri 20 km	ton	4825
12	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	1200
13	2.37/4a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 4.0 km	m3	2900
14	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2095
15	3.88/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	5287
16	An-9	Argjinature mbi mur me zhavorr per mbrotje	m3	1200
17	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1

4. NP-12 B Punime te inxhinierese se mjedisit

Te gjitha punimet kane ndikim te larte ne mjedis pasi punimet kryhen pergjat vijes lumore te lumit Osum.

1	3.2	Prerje bime te vogla F - 10 cm	m2	405
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh 10-20 cm	cope	58
3	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	2900
4	3-47/1b	Mbushje e ngjeshje me dhe	m3	1620
5	3.193/b	Shtrese zhavor lumi t=20cm, rruga	m2	3300
6	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm rruga	m2	3300
7	AN	Shtrese rere bituminoze t=8-10cm rruga	m2	3072
8	3.235+an	Struktura monolite betoni C 16/20 me 20% gur	m3	2415
9	An-50	Transport element betoni dhe b/a me auto deri 10 km	ton	5072
10	3.352	Mbushje me gur kave per skoliere	m3	2838
11	AN 51	Transport materiale ndertimi, gur kave me auto deri 20 km	ton	4825
12	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	1200
13	2.37/4a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 4.0 km	m3	2900
14	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2095
15	3.88/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	5287
16	An-9	Argjinature mbi mur me zhavor per mbrojtje	m3	1200
17	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1.NS- 18 B Punime topografike

Te gjitha punimet kane te domosdoshme rilevimet dhe kuotat pergjat vijes se projektit. Cdo punim do te kryhet pasi jane bere te gjitha rilevimet perkatese dhe kuotimet sipas projektit teknik nga autoriteti kontraktor.

2.3.3- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 79 punonjës për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit** duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 (tre) muajve të fundit të cilit I takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertave .
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën për 3 (tre) muajve të fundit të cilit I takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertave .

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8.

Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** , brenda afatit nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit të kontratës, orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për të paktën **3 (tre) muajve të fundit** duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit , tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.

Për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe dëshmi të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Nr.	Nr . An	Pershkrimi i Punimeve	Njesi	Sasi	Ore pune njesi	Ore pune Total	Dite pune
		Punime ndertimi					
1	3.2	Prerje bime te vogla F - 10 cm	m2	405	0.08	32	4.05
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh 10-20 cm	cope	58	0.40	23	2.90
3	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	2900	0.11	319	39.88
4	3-47/1b	Mbushje e ngjeshje me dhe	m3	1620	0.84	1,361	170.10
5	3.193/b	Shtrese zhavor lumi t=20cm, rruga	m2	3300	0.19	627	78.38
6	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm rruga	m2	3300	0.08	248	30.94
7	AN	Shtrese rere bituminoze t=8-10cm rruga	m2	3072		0	-
8	3.235+an	Struktura monolite betoni C 16/20 me 20% gur	m3	2415	12.80	30,912	3,864.00
9	An-50	Transport element betoni dhe b/a me auto deri 10 km	ton	5072	0.02	86	10.78
10	3.352	Mbushje me gur kave per skoliere	m3	2838	3.40	9,649	1,206.15
11	AN 51	Transport materiale ndertimi, gur kave me auto deri 20 km	ton	4825	0.02	82	10.25
12	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	1200	0.04	48	6.00
13	2.37/4a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 4.0 km	m3	2900	0.03	87	10.88
14	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar 1x1x1.5 m	m3	2095	5.30	11,104	1,387.94
15	3.88/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke per devijim lumi	m3	5287	0.15	793	99.13
16	An-9	Argjinture mbi mur me zhavorr per mbrojtje	m3	1200	0.04	48	6.00
17	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	1	61.00	61	7.63
SHUMA							6,935.0
Afati i realizimit 4 muaj (88 dit pune)							88.0
Numri total i punonjesve							

2.3.4- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi - 1 (nje)
- Inxhinier Ndërtimi profili transport - 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje);
- Inxhinier Topograf - 2 (dy);
- Inxhinier Gjeolog - 1 (nje);
- Inxhinier mjedisi - 1 (nje);

Drejtuesit Teknik të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë, të figurojnë në listë-pagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, të kenë kontratë pune të vlefshme, të deklarojnë se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera dhe, se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Për Drejtuesit Teknik duhet të dorëzojë dokumentacionin: Kontratë noteriale pune, e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë profesionale, CV, Librezë pune.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim: Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklarates së mesipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nga Administratori i shoqërisë) **Përgjegjës in Teknik të Kantierit**, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit i deklaruar, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara të Udhëzimit nr. 2, datë 13. 05. 2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe duhet te plotesoj edhe deklarate vet .

Operatori Ekonomik, për përmbushjen e këtij kriteri duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga administratori i shoqërisë për personelin kryesor, Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklarates. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim:Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre

Argumentimi *Kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Referuar rekomandimit te APP nr. 6732 prot date 21.10.2020, te cituar :

Sjellim në vëmendje të autoriteteve kontraktore, se në Kreun I/2.1, të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, përcaktohet qartësisht se: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Sa më sipër, rekomandojmë që autoritetet kontraktore të mbajnë në konsideratë dispozitën e sipërcituar, kur parashikojnë kërkesat për disponueshmërinë e drejtuesve teknik në objekt.

Nga ana tjetër, konstatohet se për përmbushjen e këtij kushti, operatorëve ekonomikë u kërkohet të paraqesin një vetedeklarim që drejtuesi/t teknik të punimeve do të jenë të pranishëm në objekt apo se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Me qëllim shmangien e keqinformimit apo paraqitjes të dokumentave me të dhëna të rreme, sa i takon deklaratës që ato japin, rekomandojmë që së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik, të kërkohet edhe dhënia e deklaratës nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik, pra dhënia e një deklaratë personale, e cila do të bashkëshoqërojë deklaratën e subjektit.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë, dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me profesione si më poshtë:

- 1 (nje) Teknik Ndertimi,
- 1 (nje) Teknik Topograf
- 4 (kater) specialist ndërtimi,
- 2 (dy) saldator,
- 2 (dy) hekurkthyes,
- 6 (gjashte) karpentier,

Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve te ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve, Diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën:

- 7 (shtate) Manovradorë/Ekskavatoristë/Automakinistë të pasqyruar në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës. Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës sipas Shtojcës Nr. 8. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM Nr. 285 datë: 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duhet të dorëzojë dokumentacionin: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kontratë pune/shërbimi të vlefshme;

1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “*Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*”, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare, akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me Ligjin Nr. 10237 datë: 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05. 05. 2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, VKM nr. 562, datë 3.7.2013” Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontratën e punës të vlefshme dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë për 3 tre muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr. 285 datë: 19. 05. 2021, secili prej operatorëve ekonomikë duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Koordinator për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë, sipas akt-marrëveshjes/kontratës së bashkëpunimit.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8.

Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht s’kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Argumentimi Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projekt idene në ternat e references, volume e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në

realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, inxhinier ndërtimi profil transport, hidroteknik topograf, gjeolog, mjedisi etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas projekt idese si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-iden duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në projekt ide.

- 1 (nje) Teknik Ndërtimi,
- 1 (nje) Teknik Topograf

Teknikat janë kërkuar për ndjekjen e punimeve të ndryshme në kantiere. Tekniku i ndërtimit me organizimet e punimeve orientimin e proceseve të punimeve të ndryshme sipas grafikut të punimeve ndërsa tekniku topograf me zbatimin edetyrave dhe piketave të përcaktuara nga inxhinier Topograf dhe ndjekja e tyre deri në zbatimin sipas projektit teknik.

- 4 (kater) specialist ndërtimi,

Për punimet e ndryshme sipas preventivit zeri me nr 3.235+An, zeri nr.3.332, zeri nr.3.287 etj

- 2 (dy) saldator,

Për punimet e ndryshme sipas preventivit zeri nr.3.332, zeri nr.3.287 etj

- 2 (dy) hekurkthyes,

Për punimet e ndryshme sipas preventivit zeri nr.3.332, zeri nr.3.287 etj

- 6 (gjashtë) karpentier,

Për punimet e ndryshme në objekt sipas preventivit zeri nr.3.89/a,3.197/b, zeri 3.212/b, zeri nr.3.352 etj. Gjithashtu për orientimin e mjeteve në kantiere.

- 7 (shtatë) Manovratorë/Ekskavatoristë/Automakinistë të pasqyruar në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për perdorimin e mjeteve të ndryshme sipas listës së mëposhtme në kantiere.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr. 742 date 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licencë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit .

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licenca përkatëse ,si dhe faturen e ketij shërbimi,sipas VKM-se nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011,të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnëpunëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merrenme çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

Argumentim : Kërkesa për mjekun e shoqërisë është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692 datë 13.12.2001, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, neni 12/2 që parashikon shprehimisht se, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

Per mjekun e kontraktuar nga jashte i jemi referuar Rekomandimit te App-se nr.6732 citon se :

Sjellim në vëmendje se, në përcaktimin e këtij kriteri duhet të mbahen në konsideratë parashikimet e Vendimin Nr. 108, datë 09.02.2011, të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, sipas të cilit, shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim:Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

2.3.8- Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”, III. 2. A.(1+2) “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis”,

Argumentim: Ne mbeshtetje te ligjit nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", Ligji nr. 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" te nryshuar si dhe VKM nr. 538, date 26.05.2009 "Per licensat dhe lejet"

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	5	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
3	Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
5	Kamion me vinç	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
6	Ekskavator me goma	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
7	Ekskavator me Zinxhire Krahegjate Mbi 15m	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
8	Fadromë me goma	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
9	Autobot uji	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
10	Greider	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
11	Autobetonierë me kapacitet 2.5 -3 m3	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
12	Wellpoint	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
13	Rul hekur gomë mbi 15 ton	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
14	Autobetonierë	4	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
15	Autopompë betoni	2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>

16	Rimorkiator	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
17	Kokë tërheqëse	1	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>
18	Armature	200 m2	<i>në pronësi ose me qira ose kontrate bashkepunimi</i>

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS, leje transporti, si dhe siguracionin e mjetit (police sigurimi) të vlefshme, dhe foto përkatëse.
- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe, siguracionin e mjetit, të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, të noterizuar, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.
- Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në regjistra publike, duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes/faturë tatimore/dokument zhdoganimi të mjetit dhe, foto të tyre. Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal, ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-bletje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme.
- Për pajisjet me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal, ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-bletje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik, duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve me targa, duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti kontraktor.

*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë-deklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojces 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben

kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të detyres se projektimit. Mjetet jane percaktuar sipas nevojës se zbatimit te projektit si me poshte:

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

"Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se "Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik"

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" neni 4 parashikon shprehimisht se: "Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim".

Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" neni 5 parashikon shprehimisht se : "Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës."

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Per mjete e marra me qera , certifikata e transportit te mallrave duhet te jete leje transporti per mallrat per perdorim nga te tretet sipas rekomandimit nr.6732 te app si me poshte :

Referuar parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët (kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit).

Kur mjetet janë për përdorim nga të tretët, duhet të pajisen me leje transporti që lëshohet për këtë qëllim. Ndërkohë, APP ka konstatuar se operatorët paraqesin në procedurë kontrata noteriale, sipas të cilave kanë marrë me qira mjete, ndërkohë që referuar lejes së transportit, janë për përdorim vetjak dhe jo për përdorim nga të tretët.

Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave

përkatës të detyres së projektimit. Mjetet janë përcaktuar sipas nevojës së zbatimit të projektit si më poshtë:

1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	5	në pronësi ose me qira/bashkepunim
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim

Keta kamiona janë të domosdoshëm pasi sipas preventivit kemi punimet zeri nr.An-50, An-51, zerin nr.2.37/4a. Gjithashtu për të gjitha shtresat e zhavorit të lumit, stabilizantit, reres bituminozer etje do të bëhet transporti i tyre për në objekt.

3	Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim

Keto mjete do të nevojiten për të sjell në kantier materialet e lehta dhe vegla pune nga me të ndryshme në kantier, po ashtu do të bëjnë të mundur dhe transportimin e stafit së bashku me puntoret çdo ditë nga kantieri.

5	Kamion me vinç	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim
---	----------------	---	------------------------------------

Keta kamion do të bëjnë të mundur transportin e materialeve të cilat e kanë të domosdoshme përdorimin e vinxhit për ngritje dhe shkarkimin e tyre si: cemento, hekur gure të ndryshme paisje të ndryshme etj ...

6	Ekskavator me goma	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim
7	Ekskavator me Zinxhire Krahegjate Mbi 15m	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim
8	Fadromë me goma	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim
10	Greider	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim

Keto mjete do të shërbejnë për kryerjen e germimeve të ndryshme sipas projektit. Po ashtu me keto mjete do të bëhet hapja dhe sistemimi i cakullit dhe shtreave përkatëse sipas projektit, kryhet levizja e materialeve brenda kantierit, krijimi i argjinaturave etj...

9	Autobot uji	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim
---	-------------	---	------------------------------------

Per furnizimin në kantier me uje

11	Autobetonierë me kapacitet 2.5 -3 m3	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim
13	Rul hekur gomë mbi 15 ton	1	në pronësi ose me

			qira/bashkepunim
14	Autobetonierë	4	në pronësi ose me qira/bashkepunim
15	Autopompë betoni	2	në pronësi ose me qira/bashkepunim

Keto mjete do te sherbejn per sjelljen e betonit per shtresat e ndryshme te planifikuara ne project, per dergimin e betonit ne zona te ndryshme dhe ne lartesi te ndryshme nepermjet autopompes se betonit dhe Vibratori ik betonit do te kryej procesin e vibrimit dhe berjen sa me kompakt sipas kushteve teknike betonin e kerkuar ne kantier.Ndersa ruli do te sherbej per ngjeshje e shtresave te ndryshme sipas analizave teknike perkatese

12	Wellpoint	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim
----	-----------	---	------------------------------------

Kjo paisje do te sherbej per largimi e ujerave gjate proceseve te punes

16	Rimorkiator	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim
17	Kokë tërheqëse	1	në pronësi ose me qira/bashkepunim

Keto mjete do te sherbejne per trasportin e mjeteve te renda ne kantier te cilat nuk levizin ne rruge si : eskavatoret me zinxhira, grejderi,fadroma, ruli hekur gome etj...

18	Armature	200 m2	në pronësi ose me qira/bashkepunim
----	----------	--------	------------------------------------

Armatura do te nevoitet per punimet e betonimet sipas specifikimeve te ndryshme ne projekt.

2.3.10. OE duhet të vërtetojë se zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe mjedisit.

Certifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

- **Certifikatë SSH/ ISO 9001:2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit/ekuivalent dhe i vlefshëm

- **Certifikatë SSH/ ISO 45001:2018** “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit/ekuivalent dhe i vlefshëm.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili nga operatorët duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojces 8. Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorezuar perben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”.

Njesia e prokurimit:

Ferdinand Avdiaj	Inxhinier	KRYETAR
Sara Satka	Juriste (personi pergjegjes i prokurimeve publike)	ANETAR
Kristina Roma	Ekonomiste	ANETAR